BalkanWeb | GAZETA SHQIPTARE

BW · Download on the App Store · GET IT ON Google Play

Fillimi > Kronikë

Emri/ Vodhi një shumë parash në një pikë karburanti nën kërcënimin e armës në Lushnjë, arrestohet autori

07 Nëntor, 2023 18:51

Madhësia e tekstit:

Arrestohet një 31-vjeçar në Lushnjë, pasi dyshohet se ka grabitur një shumë parash në një pikë karburanti. Sipas burimeve policore, autori ka qenë i maskuar dhe me armë.

Në pranga ka rënë shtetasi Fabjan Bujaraj, 31 vjeç, banues në Lushnjë.

Në cilësinë e provës materiale, policia ka sekuestruar armën e gjahut që ka përdorur autori për të kryer vjedhjen, automjetin që kishte marrë me qira, veshjet që ka mbajtur gjatë vjedhjes, një sasi lënde e dyshuar narkotike heroinë dhe një peshore elektronike.

Njoftimi i policisë:

Finalizohet operacioni policor i koduar "How it ends", për zbardhjen e një vjedhjeje të kryer në kërcënimin e armës.

Policia identifikon, kap dhe vë në pranga 31-vjeçarin që hyri i maskuar në një karburant dhe mori një shumë para, me kërcënimin e armës.

Sekuestrohen arma e gjahut e përdorur nga autori, automjeti me të cilin ai u largua pas ngjarjes, dhe veshjet që kishte gjatë vjedhjes.

Sekuestrohen edhe një sasi lënde e dyshuar narkotike heroinë dhe një peshore elektronike, që u gjetën në banesën e 31-vjeçarit, me precedent të mëparshëm në fushën e narkotikëve.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lushnjë, menjëherë pas marrjes së njoftimit për një rast vjedhjeje me armë, në një karburant, kanë organizuar punën në kuadër të operacionit policor të koduar "How it ends", me qëllim zbardhjen e vjedhjes, identifikimin dhe kapjen e autorit.

Si rezultat i veprimeve të shpejta proceduralo-hetimore, me mbështetjen e inteligjencës policore, është zbardhur ky rast vjedhjeje dhe është identifikuar autori i dyshuar, shtetasi F. B., 31 vjeç, banues në Lushnjë.

Në kuadër të operacionit pas disa orësh ndjekjeje nga shërbimet e Komisariatit të Policisë Lushnjë në bashkëpunim me shërbimet e Policisë së Elbasanit, u bë e mundur kapja në Elbasan e 31-vjeçarit.

Nga hetimet ka rezultuar se shtetasi F. B., në orët e para të mëngjesit të sotëm, ka hyrë i maskuar në një karburant dhe duke kanosur me armë gjahu, ka marrë një shumë parash (një pjesë të shiros ditore).

Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar arma e gjahut që ka përdorur autori për të kryer vjedhjen, automjeti që kishte marrë me qira, veshjet që ka mbajtur gjatë vjedhjes, një sasi lënde e dyshuar narkotike heroinë dhe një peshore elektronike.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Vjedhja me armë", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Lushnje · vjedhje

TË NGJASHME

Akoident në "Rotondon e Savrës" në Lushnjë, makina përplas këmbësorin, i lënduari rënë me urgjencë në spital
07 Nëntor, 2023

Emri/ Ndë kërkim nga drejtësia italiane për një abrit akuzash penale, pranga 22-vjeçarit në Laç
24 Tetor, 2023

Taboola Feed

Largimi i Agron Shehajt nga grupi i PD, Berisha zbardh bisedën me deputetin: I kam thënë që...
Largimi i Agron Shehajt nga grupi i PD, Berisha zbardh bisedën me deputetin: I kam thënë që...
balkanweb.com



Highspeed-Surfen: Tarife von 50-250 MBit/s
Telekom · Sponsored
Jetzt Buchen

Jetzt zuhause WLAN optimieren
Telekom · Sponsored
Jetzt Buchen

Robert Habeck will Solarenergie-Ausbau: Folgen für Hausbesitzer?
Wie Hausbesitzer von Habeck's neuen Maßnahmen profitieren könnten.
Das Solar Portal · Sponsored
Mehr erfahren

Experten sicher: Diese "Wundersubstanz" hilft bei chronischen Gelenkschmerzen...
Vitalabo · Sponsored

Sie werden nicht glauben, wie viel Spaß dieses Spiel macht!
Spiele kostenlos!
Star Of Culture · Sponsored
Jetzt spielen

TË FUNDIT NGA KRONIKË

Vendimi i Gjykatës së Strasburgut, reagon shoqata e familjarëve të viktimave të Gërdecit: U konfirmua se kemi të drejtë
07 Nëntor, 2023

"Kërndo e dëntoi ta krevat!", zbardhet dëshmia e edukatores së kopshtit privat: Vajzës e godita me...
07 Nëntor, 2023

Penalizoi 3 punonjësve të policisë, ministria e Brendshme dënon dhunën ndaj 3-vjeçarës në kopshtin privat: Të zbardhet ngjarja!
07 Nëntor, 2023

Policia reagon pas dhunën ndaj 3-vjeçarës, jepet masa për edukatoren, penalizohen tre ryrtarë të policisë (Emra)
07 Nëntor, 2023

Çpërl masiv në lëk-Kombinatin Metalurgjik, Prokuroria e Elbasanit nis hetimet për ndotje të ambientit
07 Nëntor, 2023

Seanca për krpëndshkëlakun e Himarës/ "Më Janar u emërova shef policie", dëshmitari: Më thanë se do ndërhyshin vetë për Fredi Beleriin, dhe bjëmërova...
07 Nëntor, 2023

KATEGORIA VIDEO

"Butrint", Tryeza e Specialistëve i drejtohet Gjykatës Kushtetuese: Një pikëpyetje integriteti shkancor e territorial
Fatmira Nikolli | 07 Nëntor, 2023

Piliturnh Kulla në COD me "Bustagz ne Shqipërinë e rrethuar me tata": Po më lavdërojnë shumë, çfarë po më ndiqin?
Fatmira Nikolli | 07 Nëntor, 2023

INTERVISTA/ "Zero presion te Tirana", Abazaj bën autokritikë: Mbaj përgjegjësi, ishtë rëjnënë një moment "ai", jemi për tërësi (VIDEO)
07 Nëntor, 2023

PS mësheh Asamblenë e Zgjerur në Durrës, Rama: Buxheti për vitin tjetër ka 400 mln euro për rritje pagash, renga mesatare në 2024...
07 Nëntor, 2023

Akoident në "Rotondon e Savrës" në Lushnjë, makina përplas këmbësorin, i lënduari rënë me urgjencë në spital
07 Nëntor, 2023

Policia reagon pas dhunën ndaj 3-vjeçarës, jepet masa për edukatoren, penalizohen tre ryrtarë të policisë (Emra)
07 Nëntor, 2023

© 2023 Balkanfitë. Të gjitha të drejtat e rezervuara.